

VENDIM
Nr.1282, datë 23.12.2009

**PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË
FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN
AKADEMIK 2009 - 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimi në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që fillojnë studimet në vitin akademik 2009-2010, të jetë 285, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nga kuotat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, 21 kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

3. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studimet specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

**KUOTA E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA, SIPAS
SPECIALITETEVE DHE SUBJEKTEVE TË INTERESUARA, NË FAKULTETIN E**

MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010

Nr.	Programi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Trojet shqiptare	Kuota të pambuluara	Shuma
1	Alergologji	3				2	5
2	Anatomi patologjike					3	3
3	Anestezi-reanimacion	9	-	-	-	3	12
4	Dermatologji	5	-	-	-	-	5
5	Endokrinologji	4	-	1	-	2	7
6	Gastrohepatologji					3	3
7	Hematologji	4	1	-	-	2	7
8	Diagnozë me imazhe	3	2	-	-	2	7
9	Kardiokirurgji					3	3
10	Kardiologji	5	-	2	-	5	12
11	Kirurgji e përgjithshme	5	2	-	1(Preshe)	5	13
12	Kirurgji maksilo-faciale		1			2	3
13	Lab. klinik-biokimik	2	1	1	1(Preshe)	3	8
14	Mikrobiologji	4	-	-	-	3	7
15	Mjek familjeje	9	-	-	-	26	35
16	Mjekësi interne	-	2	-	-	8	10
17	Mjekësi ligjore					2	2
18	Nefrologji		1			1	2
19	Neurologji		1			1	2
20	Neurokirurgji	-	2	-	-	5	7
21	ORL		-	1	2(Preshe)	1	4
22	Obstetrikë-gjinekologji	6	-	-	1(Preshe)	5	12
23	Okulistikë					4	4
24	Onkologji	3	-	-	-	7	10
25	Ortopedi-traumatologji					4	4
26	Pediatri	10	-	-	-	-	10
27	Pedodonti					2	2
28	Pneumonologji	-	1	-	-	8	9
29	Psikiatri	1	1	2		-	4
30	Psikiatri e fëmijëve dhe e adoleshentëve					5	5
31	Reumatologji	5	-	-	-	2	7
32	Sëmundje infektive	6	-	-	-	4	10
33	Shëndet publik	10	2	-	-	-	12
34	Terapi stomatologjike					2	2
35	Toksikologji klinike					2	2
36	Stomatologji (kirurgji orale,	-	-	-	-	35	35

	kirurgji maksilo-faciale, protetika fikse, protetika të lëvizshme, protetika kirurgjikale, ortodonci periodontologji)						
	Gjithsej	94	17	7	5	162	285